

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare - Konferencë Kombëtare
“SFIDAT E ZHVILLIMIT TË TREGJEVE NËN MBIKËQYRJEN
E AMF-SË DHE EDUKIMI FINANCIAR”
24 Maj 2018 - Tiranë, Shqipëri

DIXHITALIZIMI NË TREGUN E SIGURIMEVE

Msc. Ina SHEHU¹
Alisa ISUFI²

Abstrakti

Të flasësh për zhvillimet e fundit në botën e sigurimeve në tregun shqiptar është e vështirë dhe e komplikuar. Është e vështirë për shkak se nuk janë shumë dhe e komplikuar sepse ka shumë faktorë që duhet të merren në konsideratë. Ky punim synon të japë një paraqitje të zhvillimeve deri në ditët e sotme të tregut të sigurimeve në Shqipëri, si edhe të paraqesë disa ide të reja në lidhje me dixhitalizimin e mëtejshëm të këtij tregu duke u bazuar edhe në praktikën që përdoren në tregjet ndërkombëtare të sigurimeve.

Duke paraqitur disa rekomandime të cilat mund të jenë të realizueshme brenda 5-10 vjeçarit të ardhshëm. Si fillim, tema jep një vështrim të përgjithshëm mbi nivelin e dixhitalizimit të tregut ndërkombëtar të sigurimeve dhe si ka evoluar ai nga viti në vit, duke vënë theksin tek inovacionet që kanë lehtësuar shumë procedurat në këtë treg. Gjithashtu një paraqitje të masës së dixhitalizimit në tregun shqiptar të sigurimeve. Nga punimi gjenerohen konkluzione të vlefshme në lidhje me dixhitalizimin e mëtejshëm të tregut të sigurimeve në Shqipëri si dhe tregon se sa mundësi ka tregu ynë t’i përqafojë dhe të përshtatet me këto ide. Nga kjo temë do të shihet që disa ide të reja mund të bëhen realitet vetëm brenda 5 vjeçarit të ardhshëm dhe disa prej tyre, ato të cilat kërkojnë më tepër angazhim dhe përpjekje, mund të bëhen realitet brenda 10 vjeçarit të ardhshëm.

Fjalë kyçe: *dixhitalizim, tregu i sigurimeve, inovacione, tregu shqiptar i sigurimeve, zhvillime.*

¹ Lecturer “Aleksandër Moisiu” University, Faculty of Business, Durrës, Albania e-mail: inashehu@hotmail.it

² Student in Master of Science, “Aleksandër Moisiu” University, Faculty of Business. alisaa.isufi@gmail.com